



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina - Municipality of Prishtina



KORNIZA AFATMESME BUXHETORE PËR VITET 2016-2018



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



I. Hyrje

Ky dokument përmban vlerësimet në kuadër të Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Prishtinës për periudhën 2016-2018. KAB është e përgatitur në përputhje me procedurat e parapara në Qarkoren Buxhetore 2016/01 të lëshuar nga Ministria e Financave. KAB e Komunës së Prishtinës paraqet një mekanizëm për zhvillim të buxhetit komunal duke marrë parasysh nevojat afatgjata të komunës dhe burimet në dispozicion që ka komuna. KAB po ashtu bën ndërlidhjen e burimeve në dispozicion me prioritetet e komunës, duke u fokusuar në qëndrueshmërinë e shpenzimeve komunale gjatë periudhës së ardhshme tre vjeçare.

KAB e Komunës së Prishtinës për periudhën 2016-2018 përfshin elementet në vijim:

- (a) Parashikimet dhe supozimet ekonomike dhe buxhetore;
- (b) Përmbledhje nga strategjia zhvillimore komunale dhe planet integruese;
- (c) Totalët e vlerësuar të të hyrave nga të gjitha burimet e financimit nga grandet qeveritare, të hyrat vetjake komunale, përfshirë participimin e qytetarëve dhe bashkëfinancimet nga ministritë e linjës në përputhje me parashikimet ekonomike dhe buxhetore;
- (d) Caqet totale për shpenzime në programe dhe nën-programe buxhetore sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve për çdo vit buxhetor që do të kontribuoj në plotësimin e qëllimeve të cekura në strategjitë zhvillimore komunale dhe planet integruese komunale;
- (e) Vlerësimet e projekteve ekzistuese nga drejtoritë komunale duke i krahasuar me arritjen e prioritetëve nga strategjia zhvillimore komunale dhe planet integruese
- (f) Vlerësimet e mbështetjes së pritur të donatorëve dhe agjencive qeveritare ndërkombëtare, përfshirë bashkëfinancimin.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



II. *Parashikimet dhe supozimet ekonomike dhe buxhetore*

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) paraqet vlerësimet e hershme programore të buxhetit të Komunës së Prishtinës, të cilat vlerësime janë të ndërlidhura ngushtë me strategjinë e zhvillimit lokal ekonomik të Komunës së Prishtinës për periudhën 2016-2018. Këto vlerësime bazohen edhe në shpenzimet e mëparshme komunale dhe në projeksionet e të hyrave vetjake të komunës, të cilat parashihen me një shkallë rritje në baza vjetore. Megjithatë, vlerësimet për buxhetin e komunës së Prishtinës që dalin duke marrë parasysh kufizimet në kuadër të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) të Republikës së Kosovës të detajuara në Qarkoret Buxhetore që i lëshon Ministria e Financave janë ende të pafavorshme për zhvillimin e kryeqytetit.

Kufijtë buxhetorë për grandin e përgjithshëm dhe për grandin për shëndetësi janë të llogaritur duke u bazuar në numrin e popullsisë, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës nga viti 2011. Sipas këtij regjistrimi, Prishtina ka 198,897 banorë, ndërsa deri në vitin 2013, Qeveria e Kosovës kishte shfrytëzuar shifrën prej 388,561 banorësh për llogaritjen e kufijve buxhetor për komunën e Prishtinës, bazuar në vlerësimin e po të njëjtës agjenci. Ky vlerësim u pat bërë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, duke u bazuar asokohe në numrin e nxënësve në arsimin para universitar, që konsiderohet si një ndër shifrat më të sakta në Kosovë, duke marrë parasysh vijueshmërinë prej gati 100% në këto nivele të shkollimit, si dhe duke u bazuar në numrin e ekonomive familjare dhe numrin mesatar të anëtarëve për ekonomi familjare.

Autoritetet komunale kanë hasur në raportime të shumta për banorë të komunës së Prishtinës që janë regjistruar në vendlindjet e tyre në regjistrimin e fundit të popullsisë. Gjithashtu, është fakt që kryeqyteti gjatë ditës i shërben një numri të madh të qytetarëve të Kosovës që nuk janë banorë të Prishtinës. Prandaj, kufijtë buxhetorë të caktuar për komunën e Prishtinës janë të pafavorshëm dhe shkojnë në dëm të zhvillimit të qytetit, në dëm të ndërtimit të infrastrukturës, si dhe në dëm të shërbimeve cilësore në arsim dhe shëndetësi në këtë komunë.

Për komunën e Prishtinës duhet të ketë grand specifik të kryeqytetit, që i merr parasysh faktet e lartpërmendura, në mënyrë që kryeqyteti të ofrojë shërbime cilësore edhe për ata që nuk janë banorë të Prishtinës dhe që e kalojnë ditën në kryeqytet, por edhe për ata që banojnë në Prishtinë, por janë të regjistruar në ndonjë komunë tjetër.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në pasqyrën në vijim prezantohen vlerësimet e komunës së Prishtinës për buxhetin e vitit 2016 dhe parashikimet e hershme për vitet 2017 dhe 2018, përfshirë këtu edhe parashikimet për grandin specifik për kryeqytetin.

Tabela 1: Vlerësimet e burimeve të financimit për Komunën e Prishtinës (2016-2018)

Burimet e financimit	Buxheti aktual	Buxheti i planifikuar	Parashikimet e hershme ¹	
	2015	2016	2017	2018
Grandi i përgjithshëm	15,772,332	13,577,625	13,844,475	14,162,006
Grandi specifik për arsim	14,476,693	17,603,615	17,603,615	17,603,615
Grandi specifik për shëndetësi	4,702,522	4,702,522	4,702,522	4,702,522
Grandi specifik për kryeqytetin	-	-	12,122,001	14,477,250
Të hyrat vetjake	27,162,609	30,000,000	31,122,387	32,289,607
Gjithsej	62,114,156	65,883,762	79,395,000	83,235,000

III. Strategjia zhvillimore komunale

Duke u bazuar në objektivat e Strategjisë zhvillimore komunale për vitet 2015-2017, Kryetari i komunës, së bashku me ekipin qeverisës, ka përpiluar planin e veprimit për vitin 2015, ndërsa aktualisht është në përpilim e sipër të planit të veprimit për vitin 2016. Plani i veprimit është një dokument i detajuar, ku për secilën drejtori paraqiten qëllimet, objektivat, aktivitetet që duhet të ndërmerren për arritjen e këtyre qëllimeve dhe objektivave, kohëzgjatja e secilit aktivitetet, si dhe buxheti në dispozicion për realizimin e këtyre aktiviteteve.

Objektivat e Strategjisë zhvillimore komunale për vitet 2015-2017 janë të paraqitura si shtojcë e këtij dokumenti *Përmbledhje e objektivave të Komunës së Prishtinës për periudhën 2015-2017*.

Përveç objektivave të programit të qeverisjes së tanishme të cilat janë të shtjelluara në shtojcë, Korniza Afatmesme Buxhetore për vitet 2016-2018 është hartuar gjithashtu edhe

¹ Në mungesë të informatave specifike nga Qarkorja Buxhetore 2016/01 për parashikimet e hershme për grantin specifik për arsim dhe shëndetësi, për llogaritjen e parashikimeve të hershme për buxhetin e Komunës së Prishtinës janë marrë vlerat e njëjta për vitet 2017 dhe 2018 nga viti 2016.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



duke e konsultuar Planin Zhvillimor Komunal (PZHK), ku investimet kapitale të përcaktuara janë të reflektuara në KAB 2016-2018.

IV. Burimet e financimit

Burimet e financimit për Komunën e Prishtinës janë grand i përgjithshëm, grand i specifik për arsim, grand i specifik për shëndetësi, si dhe të hyrat vetjake të komunës.

Grandi i përgjithshëm

Komunat e pranojnë Grandin e përgjithshëm, të përcaktuar si grand me sistem të mbyllur dhe e shfrytëzojnë për ushtrimin e kompetencave të caktuara komunale në përputhje me kuadrin ligjor. Grandi i Përgjithshëm mundëson një shkallë të arsyeshme të qëndrueshmërisë në të hyrat komunale, gjithashtu është mjet adekuat për vendosjen e barazive ndërmjet komunave, dhe mundëson alokimin adekuat të burimeve për komunitet pakicë në komunat përkatëse.

Kriteret bazë të formulës për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna janë: numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); përmasat gjeografike të komunës me 6%, numri i popullsisë pakicë në komunë (3%); komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat kombëtare me dy përqind (2%).

Grandi i përgjithshëm i ndarë për Komunën e Prishtinës për vitin 2016 është në vlerë prej 13,577,625 Euro, ndërsa parashikimi për këtë grand për vitin 2017 është 13,844,475 Euro dhe për vitin 2018 është 14,162,006 Euro.

Financimi për stafin komunal që ofrojnë shërbime sociale është përfshirë në kuadër të grantit të përgjithshëm të komunës. Të punësuarit në administratën e Drejtorive Komunale për Arsim parauniversitar dhe Shëndetësi primare, në pajtim me parimet dhe kriteret e përcaktuara në LFPL, duhet të financohen nga Grandi i Përgjithshëm në komuna.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Grandi specifik për arsim

Grandi specifik për arsim sipas LFPL-së bazohet në qasjen me sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret dhe parametrat në formulën shtetërore të arsimit nga MASHT përfshirë politikat e arsimit para universitar për vitin 2016.

Grandi specifik për arsim bazohet në parametrat/kriteret si vijon:

- a) Numri i nxënësve të regjistruar dhe të raportuar nga MASHT;
- b) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3;
- c) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;
- d) Kriteret tjera për të akomoduar politikat e arsimit për vitin 2016 (pagesa e përvojës së punës, sigurimet shëndetësore);
- e) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor 1:12;
- f) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë 1:17.2 dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;
- g) Raporti nxënës-mësimdhënës për zonat malore 1:14.2;
- h) Kalkulimi për stafin mësimdhënës të gjuhës angleze për klasën I dhe II;
- i) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 nxënës 1 staf në arsimin para-fillor dhe fillor (bazuar në UA 18/2009 të MASHT);
- j) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 nxënës 1 staf në arsimin e mesëm (bazuar në UA 18/2009 të MASHT);
- k) Kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës 1 staf (pastrues) si dhe 1 staf për shkollë (roje), bazuar në UA 18/2009 të MASHT;
- l) Shërbimi profesional (pedagog) nga 4 për 7 komunat e mëdha dhe nga 2 për të gjitha komunat tjera (bazuar në vendimet e mëparshme të Komisionit të Grandeve).

Grandi specifik për arsim i ndarë për Komunën e Prishtinës për vitin 2016 është në vlerë prej 17,603,615 Euro, ndërsa parashikimet e hershme për këtë grand për vitin 2017 dhe për vitin 2018 nuk janë ofruar nga Ministria e Financave.

Grandi specifik për shëndetësi

Grandi specifik për shëndetësi dhe përcaktimi i shumës së këtij granti bazohet në një qasje me sistem të hapur të financimit në përputhje me LFPL. Propozim-granti specifik



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



për shëndetësi primare për vitin 2016 nga Ministria e Shëndetësisë është bazuar në formulën për kokë banori - numrit të vizitave shëndetësore X kostoja mesatare për vizitë, dhe numrit të shërbimeve X kostoja mesatare për shërbime.

Kriteret e aprovuara nga Komisioni i Granteve janë, si vijon:

- 2.5 vizita për kokë banori me një kosto prej 4 Euro për një vizitë, dhe
- 3.5 shërbime për kokë banori më një kosto prej 3.89 Euro për një shërbim.

Grandi specifik për shëndetësi i ndarë për Komunën e Prishtinës për vitin 2016 është në vlerë prej 4,702,522 Euro, ndërsa parashikimet e hershme për këtë grand për vitin 2017 dhe për vitin 2018 nuk janë ofruar nga Ministria e Financave.

Të hyrat vetjake

Planifikimi për të hyrat vetjake të komunës së Prishtinës për vitin 2016 është 30,000,000 Euro, parashikimi i hershëm për vitin 2017 është 31,122,387 Euro dhe për vitin 2018 është 32,289,607 Euro.

Në tabelën në vijim prezantohet planifikimi i komunës së Prishtinës për të hyrat vetjake për vitin 2016.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Tabela 2: Planifikimi për të hyrat vetjake për vitin 2016

Kategoritë e të hyrave	Planifikimi	Përqindja
Taksa për leje ndërtimi	8,500,000	28.3
Legalizimi i ndërtimeve pa leje	5,000,000	16.7
Tatimi në pronën e paluajtshme	6,300,000	21.0
Licenca në biznes	100,000	0.3
Taksa për shfrytëzimi i sipërfaqeve publike	1,100,000	3.7
Taksa për infrastrukturë rrugore	20,000	0.1
Taksa nga kadastra dhe gjeodezia	420,000	1.4
Taksa për transaksion në pronë	550,000	1.8
Taksa për certifikata dhe dokumente zyrtare	260,000	0.9
Taksa rrugore	510,000	1.7
Taksa për shërbime arsimore	1,200,000	4.0
Taksa për shërbime shëndetësore	280,000	0.9
Gjobat në trafik	400,000	1.3
Renta nga prona ne shfrytëzim	200,000	0.7
Participime / Donacione	500,000	1.7
Shpronësime të pronës komunale	1,560,000	5.2
Të hyrat nga gjykatat	600,000	2.0
Të hyrat nga parkingu dhe Hortikultura	2,500,000	8.3
Gjithsej	30,000,000	100.0

Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2016 do të arkëtohen kryesisht nga taksa për leje ndërtimi, nga tatimi në pronën e paluajtshme dhe nga legalizimi i ndërtimeve pa leje. Burime sekondare të të hyrave do të jenë gjithashtu edhe të hyrat nga parkingu, shpronësimet e tokave komunale dhe taksa për shfrytëzimin i sipërfaqeve publike. Vlerësimet e mbështetjes së pritur të donatorëve dhe agjencive qeveritare ndërkombëtare, përfshirë bashkëfinancimin e mundshme, janë përfshirë në kuadër të të hyrave nga participimet dhe donacionet.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



V. Planifikimi i shpenzimeve

Planifikimi shpenzimeve për tre vitet e ardhshme është i paraqitur në tabelën e mëposhtme, ku mund të vërehet se shumatat më të mëdha të buxhetit janë të orientuara në investime kapitale dhe në paga dhe mëditje.

Në krahasim me vitet paraprake, vlerësimi për buxhetin për paga dhe mëditje për vitin 2016 është më i lartë për shkak të përfshirjes së buxhetit shtesë për përvojë të punës. Buxheti për mallra dhe shërbime është i reduktuar në kufij jo-realë të përcaktuar nga Ministria e Financave. Buxheti për shpenzime komunale është gjithashtu në kufij jo-real dhe nuk përfshin vlerësimet për zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik, por edhe rritjen e çmimit të rrymës. Buxheti për subvencione dhe transfere është zvogëluar nga Ministria e Financave pa asnjë analizë dhe pa kurrfarë konsultimi me Komunën e Prishtinës. Ndërsa buxheti për shpenzime kapitale është rritur ndjeshëm në krahasim me vitin 2015.

Shpërndaja e buxhetit sipas kategorive është dhënë në tabelën në vijim.

Tabela 3: Planifikimi i shpenzimeve për Komunën e Prishtinës (2016-2018)

Kategoritë e shpenzimeve	Buxheti aktual	Buxheti i planifikuar	Parashikimet e hershme	
	2015	2016	2017	2018
Paga dhe mëditje	26,484,260	28,108,709	29,600,000	29,900,000
Mallra dhe shërbime	7,358,545	7,393,190	10,700,000	10,900,000
Shpenzime komunale	1,793,000	1,793,000	2,400,000	2,500,000
Subvencione dhe transfere	2,210,000	1,816,810	2,700,000	2,900,000
Investime kapitale	24,268,351	26,772,053	33,995,000	37,035,000
Gjithsej	62,114,156	65,883,762	79,395,000	83,235,000

Planifikimi i buxhetit për vitet në vijim (2017 dhe 2018) është bërë duke supozuar planifikimin e një grandit specifik të kryeqytetit. Gjithashtu, në shtojcën e këtij dokumenti, ku është paraqitur plani i investimeve kapitale për vitet 2016-2018, shumatat e planifikuara për investime kapitale për vitet 2017 dhe 2018 janë të bazuara në një rritje potenciale të buxhetit të komunës përmes grandit specifik të kryeqytetit.

Shtojca në vijim paraqet në detaje planin për investime kapitale sipas programeve dhe nën-programeve buxhetore, që janë në përputhje me strategjitë zhvillimore komunale dhe planet integruese komunale.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



VI. *Aneks 1: Përmbledhje e objektivave të Komunës së Prishtinës për periudhën 2015-2017*

Strategjia zhvillimore komunale për vitet 2015-2017 ka këto objektiva kryesore:

➤ **Rregullimin e trafiku në Prishtinë**

Reformimi i Transportit Publik

Komuna e Prishtinës ka filluar reformën në një bashkëpunim me BERZH në një program mbi 5 milion euro ku ka filluar: i) vlerësimi teknik dhe ambiental, do të vazhdohet ii) me planin e mobilitetit që do t'i caktojë linjat e reja, iii) prokurimi i autobusëve të rinj së bashku me BERZH dhe do të përfundohet me sistemin e integruar të biletave.

Kjo reformë do të krijoj sistemit të ri të linjave, sistemit të ri të pagesave dhe lirimeve për grupet e rrezikuara.

Politika të kufizimit të qarkullimit të makinave në qendër

Komuna e Prishtinës ka filluar projektin për ndërtimin e zonave të parkingut. Zonat e parkingut në Prishtinë do të ndahen në tri zona, zona qendër, zona II dhe zona III. Aplikimi fillon prej zonës qendër. Në këtë drejtim ne do të krijojmë kompaninë publike Parkingu Prishtina, me që rast tërë kohën do të përmirësohet sistemi por edhe do të rregullohet parkimi.

Komuna e Prishtinës planifikon të shtrij sistemin anti-parking në tërë qytetin e Prishtinës.

➤ **Banim i përballueshëm**

Realizimin e plan-programint për banimi social, si program 3 vjeçar, për t'u ballafaquar me nevojat e familjeve sociale si dhe për të realizuar konceptin e banimit publik.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



➤ **Vendosja e Rregullit në planifikimin urban**

Përfundimi i procesit të legalizimit - proces tre vjeçar që bëhet sipas ligjit në nivelin qendror

Planet rregullative

Realizimin e matjeve gjeodezike në çdo lagje për të bërë planet rregullative ku ka nevojë me konkurs dhe jo sipas çmimit më të lirë.

Hartimi dhe revidimi i planeve rregullative në lagjet e Prishtinës.

Incizimi i gjendjes faktike të hapësirave publike

Krijimi i hartës zonale

➤ **Furnizim i pandërprerë me ujë**

Plani i investimeve kapitale - viteve të ardhshme do të bëhen investimet kapitale në vendet ku kemi potencial për të gjetur alternativa tjera për furnizim me ujë.

Realizimi i investimeve - realizimin e investimeve të parapara për vitin 2015

➤ **Tregu i Prodhimeve Vendore**

Treg për prodhimet vendore

Krijimin e tregut mobil të prodhimeve vendore në Prishtinë në të cilin bujqit do t'i shesin prodhimet e tyre.

Themelimi i Drejtorisë së Bujqësisë nga 1 janari 2015

Krijimi i strategjisë së zhvillimit rural, jo vetëm përmes subvencioneve por rikrijimit të gjithë zinxhirit të prodhimit vendor.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



➤ **Çerdhe të përballueshme me kosto të përballueshme për çdo të Komunës**

Hapja e çerdhe me bazë në komunitet në çdo lagje të Prishtinës. Me këtë synojmë zgjedhjen e problemit që vazhdon të ketë Prishtina me mungesën e çerdheve.

➤ **Arsimi në funksion të zhvillimit**

Fillimi i planifikimeve për realizimin e muzeut shkencor.
Shkarkimi i shkollave në qytet duke ndërtuar shkolla të reja dhe anekse

➤ **Shëndeti në shërbim të zhvillimit**

Renovimi dhe modernizimi i QMF-ve

➤ **Kultura më afër qytetarit**

Zhvillimit e artit në hapësirat publike
Ndërtimin e muzeut të qytetit
Ndërtimi i pishinës olimpike
Ndërtimin e sallës koncertale në qendër të qytetit

➤ **Një Prishtinë për qytetarë**

Renovimin e hapësirave komunale dhe vënja e tyre në shërbim të komunitetit
Fillimi i programit "Safe City" (Qytet i Sigurt)
Lirimin e hapësirave publike dhe zgjerimin e zonave të gjelbërimit
Realizimin e plotë të projektit për mbeturina nëntokësore
Krijimin e parqeve për të rritur dhe krijimin këndeve të lodrave për fëmijë në çdo lagje të Prishtinës

➤ **Digjitalizimi i Prishtinës**

Krijimi i qendrës për teknologji informative (TIK) dhe digjitalizimin e të gjitha shërbimeve në Prishtinë

Instalimin dhe funksionalizimin e softuerit për tatim në pronë